EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT
JETË DHE AKSIDENTE NË GRUP

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e sigurimit Jetë dhe Aksidente në Grup është kontrata në të cilën Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të siguruarin në mënyrën dhe masën e parashikuar në këtë kontratë nëse ndodh dhe vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1 Përcaktime

a) Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të Jetës dhe Aksidenteve në Grup, polica e sigurimit dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet atyre, do të quhet **"Kontrata e Sigurimit".**
b) Kushtet e përgjithshme (dhe të veçanta nëse ka) të kontratës së sigurimit të Jetës dhe Aksidenteve në Grup, do të quhen **"Kushtet e sigurimit"**.
c) Shoqëria e Sigurimit "SiCRED", do të quhet **"Siguruesi".**
d) Personi fizik, pjesëmarrës në Grupin e siguruar, jeta e të cilit do të sigurohet sipas kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"I Siguruari".**
e) Personi fizik apo juridik, që nënshkruan kontratën e sigurimit, do të quhet "**Kontraktuesi".**
f) Dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Polica e sigurimit".**
g) Dëshmia e sigurimit që "Siguruesi" i lëshon të "Siguruarit, do të quhet **"Çertifikatë e Sigurimit".**
h) Personi fizik apo juridik, që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur nga i siguruari në çertifikatën e sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Përfituesi".**
i) Shuma e mjeteve monetare që i Siguruari dhe/ose kontraktuesi i paguajnë Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate, këtu e më poshtë, do të quhet **"Prim i sigurimit".**
j) Shuma maksimale e mjeteve monetare, që Siguruesi merr përsipër të paguajë me vërtetimin e rastit të sigurimit, në favor të të Siguruarit apo Përfituesit, do të quhet **"Shuma e sigurimit".**
k) Shuma e mjeteve monetare, që Siguruesi i paguan të Siguruarit apo Përfituesit, me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit, do të quhet **"Përfitim".**
l) Në rastet kur pagesa e Primit të Sigurimit, sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga i siguruari, tërësisht ose pjesërisht, kjo kontratë do të quhet **"Kontratë sigurimi kontributor në grup".**
m) Në rastet kur pagesa e Primit të Sigurimit, sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga punëdhënësi, kjo kontratë do të quhet **"Kontratë sigurimi në grup".**
n) Punëdhënësi i cili paguan plotësisht apo pjesërisht primin në favor të të Siguruarit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Policëmbajtësi".**
o) Vdekja e të Siguruarit, si dhe të gjitha llojet e paaftësisë së personit, kur ato nuk përfshihen në rreziqet e përjashtuara të kësaj kontrate sigurimi, do të quhen **"Rasti i sigurimit".**
p) Vdekja ose paaftësia e të siguruarit që shkaktohen nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme, të jashtme, të pavarura nga vullneti i të siguruarit, do të quhet **"Aksident**".
q) Vdekja e të siguruarit, pavarësisht nëse është shkaktuar ose jo nga Aksidenti, me përjashtim të rreziqeve të përjashtuara në këtë kontratë sigurimi, do të quhet **"Vdekja e të siguruarit".**
r) Humbja e plotë e aftësisë së të siguruarit për të kryer detyrat në profesionin e tij ose në çdo profesion tjetër, shkaktuar nga aksidenti dhe vërtetuar si e tille nga autoriteti mjekësor kompetent, pas mbarimit të periudhës prej 1 viti nga fillimi i paaftësisë, do të quhet **"Paaftësi e përhershme e plotë".**
s) Humbja e pjesshme e aftësisë për punë, shkaktuar nga aksidenti, me pasojë humbjen anatomike apo dëmtimin funksional të përhershëm të një ose disa organeve apo gjymtyrëve të të Siguruarit, do të quhet **"Paaftësi e përhershme e pjesshme".**
t) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit, shkaktuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet "**Paaftësi e përkohshme e plotë".**

u) Humbja e pjesshme e aftësisë së Siguruarit, shkaktuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet "**Paaftësi e përkohshme e pjesshme".**
v) Shpenzimet e kryera për trajtimin spitalor dhe ndërhyrjet kirurgjikale, shpenzimet për blerjen e medikamenteve mjekësore të rekomanduara nga mjeku, trajtimin me rreze, shpenzimet e bëra për transportimin e të siguruarit për në spital (kur ky transportim kërkon kushte specifike) të cilat lindin si pasojë e aksidentit, do të quhen **"Shpenzime mjekësore**".
w) Humbja fizike ose funksionale e një dore, në ose mbi artikulacionin e brrylit, apo e një këmbë, në ose mbi artikulacionin e gjurit, do të quhet **"Humbje gjymtyre".**
x) Limiti maksimal i shumës monetare, që Siguruesi merr përsipër të paguajë, në ndodhjen e rastit të sigurimit, do të quhet **"Përgjegjësi agregate".**
y) Kohëzgjatja, për të cilën është në fuqi kontrata e sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Periudha e sigurimit".**

1.2 E drejta për t'u Siguruar

a) Kanë të drejtë të sigurohen persona me moshë nga 18 vjeç deri në 65 vjeç, anëtarë të "grupit të sigurimit".
b) Nuk do të konsiderohen të "Siguruar" dhe nuk kanë të drejtë të bëjnë pjesë në grup, sipas kushteve të sigurimit të parashikuara në këtë kontratë sigurimi, personat që nuk kanë arritur moshën 18 vjeç ose janë mbi 65 vjeç.
c) Nuk do të konsiderohen të siguruar ata persona që kërkojnë kujdes të përhershëm mjekësor ose që e mbështesin jetesën në kujdesin e të tretëve.
d) Të Siguruarit që arrijnë moshën kufi 65 vjeç, kur kontrata e sigurimit është në fuqi, do të mbeten të mbuluar deri në mbarim të afatit të treguar në këtë kontratë sigurimi.

1.3 Përfitimet e Pagueshme

Kontrata e Sigurimit mbulon shpenzimet që janë të lidhura me:

a) Përfitimi për vdekjen natyrore;
b) Në rast vdekje aksidentale;
c) Përfitimi për paaftësinë e përhershme të plotë të shkaktuara nga aksidenti:
   I. *Humbja totale dhe e pariparueshme e shikimit në të dy sytë;*
   II. *Humbja totale nga gjymtimi fizik apo humbja e funksionit të dy duarve në ose mbi nivelin e kyçit.*
   III. *Humbje fizike apo funksionale e dy gjymtyrëve të poshtme në apo mbi artikulacionin e gjurit.*
   IV. *Humbja fizike apo funksionale e një gjymtyre të sipërme dhe një gjymtyre të poshtme së bashku.*
d) Përfitimi për Paaftësinë e Përhershme të pjesshme;
e) Përfitimi për paaftësinë e përkohshme të plotë;
f) Përfitimi për paaftësinë e përkohshme të pjesshme;
g) Përfitimi për trajtimin mjekësor jashtë shtetit;
h) Përfitimi për shpenzime mjekësore.

1.4 Përjashtimet

Për efekte të kësaj kontrate sigurimi nuk do të mbulohet rasti i sigurimit shkaktuar në kushtet e:

a) Lufta, (vetëm nëse është e shpallur nga organet kopetente) veprimet ushtarake, lufta civile, rebelimi, kryengritje të armatosur, dhe akte terroriste.
b) ***Veprimi i armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike.***
c) Kontaminimit radioaktiv, shpërthimeve bërthamore, përmbytjeve, zhvendosjes së tokës, tërmeteve, shpërthimeve vullkanike, reaksioneve bërthamore, rrezatimit bërthamor; sëmundjeve infektive masive, pandemike dhe bioterrorizmit.
d) Drejtimit të mjeteve motorrike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i pajisur me dëshminë përkatëse të aftësise, pjesmarrja në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer); gjatë ushtrimit të sporteve dimërore, garave me kuaj, makina dhe motoçikleta, etj.
e) Përdorimit të lëndëve eksplozive dhe korodive, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale;
f) Përfshirjes së të siguruarit në veprimtari të paligjshme, apo kriminale.

g) Vetëvrasjes nëse ndodh brenda 6 muajve të parë të lidhjes së kontrates
h) Akteve të kryera me dashje apo të tentuara nga Policmbajtësi, kontraktuesi apo përfituesi në dëm të të siguruarit.
i) Pjesëmarrjes së të siguruarit në sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme të provokuara nga të tretët, përveç kur i siguruari vepron në kushtet e vetëmbrojtjes a të nevojës ekstreme.
j) Influencës së alkoolit apo drogës, sëmundjeve veneriane, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, sëmundjeve si pasojë e virusit HIV.
k) Çdo lloj defekti fizik apo mendor priekzistues, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i siguruari dhe është pranuar nga siguruesi.
l) Ndërhyrjeve kirurgjikale, kontrolleve apo kurimit për pasoja që nuk lidhen me kushtet e mbulimit në sigurim sipas kësaj kontrate.
m) Përjashtohen nga përfitimi për paaftësi të çdo lloji, e përhershme apo e përkohshme që shkaktohet nga sëmundje apo patologji të ekzistuara më parë apo të shfaqura pas hyrjes në fuqi të kontratës, gjatë shtatëzanisë, lindjes së fëmijës apo abortit, pavarësisht nga natyra e tyre që do të përbënin rrethanë apo fakt me njohjen e të cilave siguruesi nuk do të pranonte lidhjen e kontratës së sigurimit.
n) Sëmundjeve të njohura, trajtuara apo diagnostikuara përpara marrjes në sigurim.

1.5 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

1. Me ndodhjen e rastit të Sigurimit, i Siguruari apo Përfituesi detyrohen të njoftojnë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe të zbatojnë porositë e dhëna nga Siguruesi.
2. Një njoftim i tillë do të quhet i dhënë Siguruesit menjëherë nëse është bërë me shkrim brenda 24 orëve nga ndodhja e Rastit të Sigurimit dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga çasti kur i siguruari është në gjendje mendore a fizike të kryejë njoftimin, nga çasti kur familjarët e të siguruarit a përfituesi kanë dijeni për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit.

a) **Për të gjitha pagesat e përfitimit në rast dëmtimi aksidental i të siguruarit me pasojë paaftësinë e përhershme apo të përkohshme të tij përcillet dokumentacioni si vijon**:

I. Kërkesa për rimbursim për shpenzimet mjekësore sipas formularit të përgatitur nga siguruesi, i plotësuar nga i siguruari, së bashku me çertifikatën e Sigurimit dhe/ose policën e sigurimit
II. Dokument i vlefshëm identifikimi;
III. Dokumentacion Mjekësor, për ekzaminimet e kryera nga i siguruari pas aksidentit;
IV. Deklaratë zyrtare nga punëdhënësi/Raporti zyrtar apo vërtetim i dhënë nga autoritetet përkatëse të vendit për aksidentin e ndodhur, rrethanat dhe dëmtimet;
V. Çdo dokument të kërkuar nga Siguruesi i cili vërteton detyrimin e tij për të paguar;

b) Në rast vdekje të personit të siguruar pavarësisht nëse ndodh nga shkaqe natyrore apo aksidentale, trashëgimtari i tij apo nga përfituesi i sigurimit duhet të paraqesë:

I. Raporti zyrtar apo vërtetim i dhënë nga autoritetet përkatëse për aksidentin e ndodhur, rrethanat dhe dëmtimet;
II. Raportin e autopsisë;
III. Çertifikata e vdekjes;
IV. Vendimi i gjykatës për trashëgiminë.

c) Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

1.6 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.